

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI I EDUKIMIT**



PUNIM DIPLOME

Fjolla Ahmeti

Mitrovicë, 2020

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
PROGRAMI FILLOR**



PUNIM DIPLOME

**TEMA: MËNYRA E MOTIVIMIT TË FËMIJËVE
PËR RUAJTJEN E MJEDISIT JETËSOR**

**Mentori:
Prof. Dr. Qerim Selimi**

**Kandidatja:
Fjolla Ahmeti**

Mitrovicë, 2020

PUBLIC UNIVERSITY OF MITROVICA „ISA BOLETINI“

FACULTY OF EDUCATION

DEPARTMENT: PRIMARY PROGRAM



BACHELOR THESIS

**THEME: CHILDREN MOTIVATION METHOD
ON LIVING ENVIRONMENT PROTECTION**

Mentor :

Prof. Dr. Qerim Selimi

The candidate:

Fjolla Ahmeti

Mitrovicë, 2020

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”
FAKULTETI EDUKIMIT**

DEPARTAMENTI: PROGRAMI FILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Bazat e shkencave natyrore me metodologji II

Titulli i punimit: Mënyra e motivimit të fëmijëve ruajtjen e mjedisit jetësor

Emri dhe mbiemri: Fjolla Ahmeti

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës (ID Regjistri) 1406011113

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Fillor

Mentori i punimit: Prof. Dr. Qerim Selimi

Aprovuar prej komisionit:

1. _____Mentor
/Emri Mbiemri, Titulli /
2. _____Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /
3. _____Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

Deklarata e Origjinalitetit / Autorësisë

Ky Punim Diplome i nivelit bachelor është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencor, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit. Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UMIB.

Statement of Originality / Authority

This Diploma Thesis, bachelor level, is my original work, respecting the authorship of any source of information and rules for a proper scientific work, and has not been submitted in whole or in part to any degree at this or any other university. According to my knowledge, the paper does not contain any material published or written by any other person except as stated in the text. Also, i declare that writing the thesis i have respected the ethical rules of the scientific and academic work of UMIB.

Data\ Date: 2020

Studentja:

(nënshkrimi- signature)

FALËNDERIM

Rruga deri te diplomimi ka qenë e gjatë dhe me shumë sfida, mirëpo falë përpjekjeve dhe ndihmës që më kanë ofruar njerëzit më të afërt, kam arritur që t'i përfundoj me sukses studimet, dhe si kurorëzim edhe punimin e temës së diplomës me titull “Mënyra e motivimit të fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor”.

Me këtë rast, dua t'u shpreh mirënjohje dhe t'i falënderoj nga zemra, të gjithë ata që më mbështetën dhe më ndihmuan në formulimin dhe finalizimin e punimit të temës së diplomës.

Fillimisht, falënderoj familjen time, e cila më kuptoi dhe më përkrahu pa rezervë në të gjitha aspektet, deri në finalizimin e këtij punimi;

Falënderoj të gjithë kolegët të cilët gjatë këtyre vite studimesh, më kanë dhënë kurajë dhe më kanë ndihmuar, kur kam pasur nevojë;

Falënderoj të gjithë profesorët të cilët më përkrahën, dhe dhanë maksimumin e tyre për të arritur suksesin me të cilin mburrem;

Kurse, në veçanti, dua të falënderoj mentorin tim Prof. Dr. Qerim Selimi, i cili nuk hezitoi për asnjë çast që të më udhëzojë drejt punës së mirëfilltë, duke më ofruar përkrahjen e tij, që nga fillimi i punës, e deri në hartimin e plotë të draftit final të temës.

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT / AUTORËSISË.....	II
FALËNDERIMI.....	III
PËRMBAJTJA.....	IV
LISTA E GRAFIKONEVE.....	V
ABSTRAKTI.....	VI
ABSTRACT.....	VII
I. HYRJE	1
II. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME MBI MOTVIMIN	2
III. MËNYRA E MOTIVIMIT TË FËMIJËVE PËR RUAJTJEN E MJEDISIT JETËSOR.	11
IV. FAKTORËT NDOTËS DHE MBROJTJA E MJEDISIT	21
V. METODOLOGJIA	25
VI. REZULTATET.....	28
VII. DISKUTIMI	32
VIII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	35
LITERATURA	36
SHTOJCAT	39

LISTA E GRAFIKONEVE

Grafikoni 1. Pëqindja e nxënësve meshkuj dhe femra.....	28
Grafikoni 2. Format e ndotjes së shkaktuar nga njeriu	28
Grafikoni 3. Ndotësit e atmosferës	29
Grafikoni 4. Ndotësit e ujit	29
Grafikoni 5. Veprimet që ndikojnë në ndotjen e ujit	29
Grafikoni 6. Shkaktarët që ndikojnë në ndotjen e atmosferës-ajrit	30
Grafikoni 7. Niveli i pastërtisë së mjedisit jetësor	30
Grafikoni 8. Niveli i pastërtisë së mjedisit mësimor.....	30
Grafikoni 9. Ndotësi më i madh i ambientit	31
Grafikoni 10. Ndikimi i njeriut në ruajtjen e mjedisit	31
Grafikoni 11. Veprimet për ruajtjen e tokës	31

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë dhe të paraqesë një pasqyrë të plotë të mënyrave të motivimit të fëmijëve në shkollë për ruajtjen e mjedisit jetësor. Gjithashtu, ky studim ka për qëllim të paraqesë edhe ndikimin e mënyrave të ndryshme të cilat përdoren nga mësuesit për motivimin e nxënësve, që ndikojnë pozitivisht në motivimin e tyre, e po ashtu edhe nxitjes dhe vlerësimit të tyre.

Për të përshkruar marrëdhëniet midis mënyrave të vlerësimit dhe faktorëve të motivimit u përdor metoda cilësore. Instrumentet e përdorura ishin pyetësi dhe intervistat me nxënësit, i cili u krye me 60 nxënës të klasave të dyta, ku 33 prej tyre kanë qenë të gjinisë femërore dhe 27 të gjinisë mashkullore.

Nga gjetjet e këtij studimi ka rezultuar se mënyrat që përdor mësuesi me nxënësit për motivimin sa i takon ruajtjes së mjedisit janë të kënaqshme.

Si përfundim, mund të pohohet se gjetjet e këtij studimi mund të ndihmojnë mësuesit për rifreskimin e mënyrave të motivimit, me qëllim nxitjen e nxënësve në kuptimin dhe rëndësinë që ka vlerësimi dhe ruajtja e mjedisit jetësor.

Fjalët kyçe: motivimi, mënyrat e motivimit, ruajtja e mjedisit, shkollë, nxënës.

ABSTRACT

The purpose of this paper is to analyze and present a comprehensive overview of the methods of motivating children in school to protect the environment. Also, this study aims to present the impact of different methods that are used by teachers to motivate students, which positively affect their motivation, as well as their encouragement and assessment.

Qualitative methods were used to describe the relationships between assessment methods and motivation factors. The instruments used were questionnaires and interviews with students, which were conducted with 60 second graders, of which 33 were female and 27 were male.

From the findings of this study it has resulted that the methods that teachers use with students to motivate them regarding environment protection are satisfactory.

In conclusion, we can agree that the findings of this study can help teachers to refresh the motivational methods, in order to encourage students in the understanding and importance of the assessment and the protection of the living environment.

Keywords: motivation, motivation methods, environment protection, students.

I. HYRJE

Objekt studimi në këtë temë diplome është motivimi i fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor. Në këtë kontekst, jemi munduar që të paraqesim një panoramë sa më të qartë të metodave dhe mënyrave të cilat duhet të ndiqen nga çdo mësimitdhënës për një edukim sa më të mirë të fëmijëve, duke i motivuar ata që ta kuptojnë sa më shumë rëndësinë e pastërtisë së ambientit në të cilin jetojmë.

Në këtë kohë, kur shumë organizata botërore po bëjnë thirrje për një mjedis sa më të pastër, kur dihet mirëfilli se edhe shëndeti i mbarë globit varet nga kjo, institucionet shkollore duhet të jenë sa më vigjilente për sa i takon kësaj çështjeje mjaft të ndjeshme. Nga ana tjetër, duke filluar nga familja dhe prindërit, të cilët janë baza fillestare e edukimit të fëmijëve për çështjen e rëndësisë së mjedisit, mësimitdhënësit dhe në përgjithësi institucionet shkollore, duhet të kenë një komunikim reciprok, duke hulumtuar e përpiluar kështu, strategji motivuese sa më adekuate në programet shkollore, që nxënësit ta kenë më të lehtë ta kuptojnë dhe pranojnë rëndësinë e ambientit dhe mjedisit që i rrethon.

Në këtë aspekt, në kapitujt vijues të këtij studimi, jemi munduar t'i hedhim fillimisht, një vështrim të përgjithshëm nocionit "motivim", për ta kuptuar më mirë rëndësinë dhe rolin e tij në etikën profesionale e shoqërore. Më tej, kemi bërë një analizë më të detajuar të ndikimit dhe efektit që ka motivimi në aspektin e edukimit të fëmijëve për çështjet mjedisore, për të vazhdat më tej me vet problematikat që ne si banorë të tokës, i shkaktojmë planetit tonë.

Brenda këtij studimi, kemi përfshi edhe një pyetësor, me të cilin kemi intervistuar gjashtëdhjetë nxënës nga tri shkolla të ndryshme të komunës së Mitrovicës, rreth asaj se sa janë të informuar ata për ndotjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

II. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME MBI MOTVIMIN

2.1. Roli dhe rëndësia e motivimit në aspektin edukativ

Termi motivim është përcaktuar në mënyrë tipike si një emocion, dëshirë, nevojë ose impuls që vepron për të nxitur veprimet. Ai është diçka që vjen nga brenda organizmit, por njëkohësisht, njerëzit janë të motivuar edhe nga nxitjet e jashtme.¹ Megjithatë, kjo nuk e kundërshton idenë se baza motivuese e individit vjen së brendshmi. Motivimi është procesi që nxitë sjelljen, dhe ky proces nuk mund të matet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të vëzhguar. Ai shpesh mund të përdoret si një mjet për të parashikuar sjelljen e individëve në vendin e punës, ndryshon shumë mes individëve, dhe duke u kombinuar me aftësitë dhe faktorët e mjedisit, ndikon në sjelljen dhe performancën e punonjësve. Duke qenë se motivimi në vendin e punës ka një rol të rëndësishëm të sjellja dhe performanca e punonjësve, ai është çelësi për institucionet e organizatat që të kuptojnë dhe të strukturojnë këto mjedise.

Në këtë kontekst, motivimi i punonjësve në institucionet shkollore është një nga çështjet e rëndësishme, nisur nga përgjegjësitë që ata kanë mbi njohuritë dhe aftësitë e nxënësit. Performanca e tyre është një shqetësim për të gjithë shoqërinë, lidhur me dhënien e njohurive dhe aftësive të nxënësit, përdorimin e metodave të mësimdhënies, kënaqësinë që ata shfaqin për punën, etj.

Kështu pra, institucioni shkollor ka një rëndësi të madhe në edukimin e brezit të ri dhe në procesin e të nxënës të tyre, që ndikon drejtpërdrejt në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në të ardhmen. Në lidhje me procesin motivues janë vërejtur formulime në shumë drejtime të reja. Përparimet në shkencën psikologjike, përfshirë aspektin e personalitetit, afeksionit dhe shkencave njohëse, kanë nxitur metoda dhe paradigma të reja, si dhe pyetje në lidhje me aspektin e sjelljes motivuese në punë. Mësuesi pra,

¹ Locke, A. Edvin (2008), International Encyclopedia of Organization Studies, Thousand Oaks: f. 3.

është subjekti që i jep institucionit besueshmëri. Ai luan një rol themelor në formimin e kapitalit njerëzor. Çdo aspekt që ndikon në rritjen e motivimit dhe kënaqësisë së tyre në punë, duhet të shihet si i rëndësishëm. Ai është aktori kryesor që duhet të zhvillojë mësimdhënien, me synim zotërimin e kompetencave themelore në bazë të standardeve të të nxënësve, duke përzgjedhur ndërmjet metodave bashkëkohore më të mira, vendase dhe të huaja.

2.2. Sfidat e mësuesit drejt motivimit të nxënësve

Mësuesit pothuajse çdo ditë, përballen me sfida të reja, nga sigurimi që aktivitetet e klasës të arrijnë standardet e deri tek adaptimi i planeve mësimdhënëse për t'ju përshtatur programit mësimor. Duket sikur çdo ditë është një aventurë, dhe mësuesit duhet të përpiqen që të bëjnë shumë detyra në të njëjtën kohë. Në vazhden e gjithë këtyre aktiviteteve që ata kanë çdo ditë, mund të harrojnë të marrin në konsideratë perspektivën e ndonjë nxënësi. Por duhet që ata të rishikojnë rëndësinë e mbajtjes së një mjedisi pozitiv në mënyrë që nxënësit të ndihen më mirë. “Nëse marrëdhënia ndërmjet mësuesit dhe nxënësit është e mirë, atëherë do të kenë përfitime të dyja palët.” (Keshilla, 2019).²

Duke pasur këtë në mendje, mësuesit duhet të përpiqen të mësojnë sa më shumë për nxënësit e tyre dhe të shtojnë sa më shumë informacion që të jetë e mundur për të ilustruar mësimin. Nxënësit që ndjejnë një lidhje të fortë me mësimin janë më të predispozuar që ti kushtojnë vëmendje dhe të marrin pjesë.

Lëvdatat e drejtpërdrejta janë një mënyrë shumë efektive për ti inkurajuar ata që të vazhdojnë me një sjellje të mirë si, pjesëmarrje aktive, qetësi kur punojnë në grup, si dhe sjelljen e shembujve të përshtatshëm për të nxitur diskutimin në klasë. Edhe një

² <https://www.keshilla.net/mesuesi-dhe-motivimi-i-nxenesit/> (Lexuar më 01.06.2020).

buzëqeshje e mësuesit mund të jetë shumë për të inkurajuar vetëbesimin dhe sjelljen e nxënësve.

Inkurajimi i nxënësve do të ushqejë marrëdhënie të mira gjatë gjithë vitit shkollor. Ata duhet të konsiderojnë që të ruajnë hapësira të veçanta për të ekspozuar punët e nxënësve, si ese, projekte, apo kërkime duke treguar kështu cilësitë që mësuesve ju duken më të rëndësishme në një detyrë. Kur një mësues të vlerësojë punën e një nxënësi, ai duhet që së pari të monitorojë dhe identifikojë atë që nxënësi ka bërë mirë. Vetëm nisur nga kjo pikëpamje, ata mund të bëjnë sugjerime për përmirësime. Mësuesit duhet që të kuptojnë si dobësitë ashtu edhe prirjet e nxënësve të tyre me anë të reagimeve të tij të mirë planifikuara. Në këtë kontekst, nga psikologjia është e njohur se me nocionin motivim i nxënësve nënkuptohet sistemi i nxitjeve, shtytjeve apo i cjtjeve të aktiviteteve intelektuale, emocionale, sociale, motorike e kështu me radhë”.³ Motivimi është faktori kryesor i mësimdhënies dhe nxitësi i cili e shton aktivitetin e nxënësve, interesimin dhe vullnetin e tyre. Kështu, nxënësit duhet të dinë se çfarë presin nga procesi mësimor, të kenë interes për të nxënë, të kërkojnë mësimdhënien më të mirë të mundshme dhe të përqafojnë teknologjinë. Të pyesin veten: Pse po e bëj këtë? A do të kem sukses? Vetëm kështu do të kenë motivim. Nuk duhet kurrë të pengojnë mendimet, por të jenë kureshtarë dhe krijues. Robert Schuller thotë: “Ju nuk mund të shtyni askënd deri te shkallët, nëse nuk është i gatshëm të ngjitet vetë”.

Por, nga ana tjetër, nëse nxënësit vijnë në shkollë të pangrënë, të sëmurë, të veshur keq, pas një zënke mes prindërve të dëgjuar që në mëngjes, pa ndjenjën e dashurisë e të sigurisë, të kërcënuar, ata nuk janë të motivuar të kërkojnë përvetësimin e njohurive. E në këto momente vjen në ndihmë mësuesi, i cili si një element i rëndësishëm duhet të jetë i trajnuar, i përkushtuar, i përgjegjshëm, të kujdeset për nxënësit e tij, për të ardhmen e tyre. Duhet të tregojë entuziazëm gjatë procesit mësimor duke bërë që të rritet vëmendja e nxënësve gjatë ligjëratave të tij. Pra,

³ Corno, L. (1994). Student vullnetin dhe arsimit: Rezultatet, ndikimet, dhe praktikat. Në Zimmerman BJ & NQ SCHUNK (ed.), Vetë-rregullor i të mësuarit dhe të performancës (f. 229-254). Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.

mësuesit duhet të jenë ata që të fuqizojnë nxënësit duke u dhënë detyra sfiduese, duke u dhënë një ndjenjë autonomie, duke i ndihmuar ata që të zhvillojnë aftësi për të mësuar e vetëdrejtuar. Mësuesit duhet të kualifikohen për të fituar cilësi të reja, pasi ata janë modele për nxënësit. Marrja e rezultateve të ulëta të nxënësi, mund të sjellë humbjen e shpresave për të arritur rezultate të larta, por mësuesi i motivon nxënësit duke u qëndruar pranë, duke njohur anët e dobëta të tyre, duke njohur ankthin që mund të kenë, dhe i motivon në shpresën për sukses.

Prandaj, do të ishte shumë konstruktive, nëse çdo mendim, opinion, mirëpritjet nga mësuesi me kërkuesin, habi dhe interes të madh. Madje një përshëndetje e këtij mendimi apo angazhimi me një vlerësim si “të lumtë”, “vazhdo kështu se shumë mirë është”, “faleminderit për mendimin tuaj, ishte mjaft i interesant”, etj., lënë përshtypje pozitive për nxënësin, dhe ai tani krijon bindjen se është subjekt i cili mund të kontribuojë në vetvete dhe në klasë. Po ashtu, mësuesi duhet t’i stimulojë nxënësit edhe përmes premtimeve dhe dhuratave, por duhet të jetë i vëmendshëm se nëse ato nuk realizohen me kohë dhe me vend, kanë gjasa të destimulojnë veprimtarinë e mëtutjeshme të nxënësve në lëndën përkatëse.

Kërkohet vazhdimisht që të aktivizohen nxënësit të cilët rrinë mbyllur, të pamotivuar, të pa interesuar apo që janë introvert. Arsimtari me kohë duhet t’i verifikojë dhe identifikojë rastet e tilla, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme në integrimin e tyre aktiv në procesin mësimor.

2.3. Shkallët e motivimit në procesin e të nxënësit

Shumë psikologë mendojnë se koncepti për vetveten përbën themelin e zhvillimit si shoqëror ashtu edhe emocional. Koncepti për veten evoluon nëpërmjet vetëvlerësimit konstant në situata të ndryshme. Fëmijët e vegjël janë të prirë të kenë një imazh pozitiv optimist për veten e tyre. Vlerësimi për veten është reagim efektiv, një gjykim për vlerësimin e vetes. Këtu përfshihet besimi në vetvete, krenari për atë që personi ka. Nëse nxënësit gjykojnë veten në mënyrë pozitive, nëse u pëlqen ajo që shikojnë te

vetja e tyre themi se ata kanë një vetëvlerësim të lartë për veten e tyre. Vetëvlerësimi pozitiv i nxënësve është i lidhur direkt me rezultatet më të mira në shkollë.

Nxënësit që kanë rezultate të mira në shkollë, janë të orientuar drejt zotërimit, dhe këta nxënës nuk kanë frikë nga dështimi, sepse dështimi nuk kërcënon sensin e tyre për zotësinë dhe vlerën e vetvetes. Ata u atribuojnë suksesin përpjekjeve të veta, kështu që marrin përgjegjësi për të nxënët e tyre dhe kanë sens të fortë për vetë efikasitetin. Ata performojnë mirë në situatë konkurruese, mësojnë shpejt, kanë një vetëbesim të lartë, kanë energji dhe janë më të gjallë dhe më krenar në krahasim me të tjerët. Nxënësit e tillë në këtë moshë e shohin veten më lartë se shokët e tyre, madje ata fillojnë të bëjnë edhe një seleksionim të shokëve. Ata e kanë fituar këtë të “drejtë” nga pozicioni në të cilin e kanë vendosur veten, jo vetëm ata, por edhe mësuesi i tyre. Pra, këta nxënës nuk është se kanë shumë nevojë për nxitje nga ana e mësuesit. Nevojë më tepër kanë ata nxënës që janë të pamotivuar dhe që kanë një vetëvlerësim të ulët. Atyre u mungon një sens i fuqishëm për zotësinë dhe vetëvlerësimin. Këta nxënës krijojnë një ide për veten në bazë të notës që marrin. Ata reagojnë ndaj dështimit duke u fokusuar dhe më shumë në paaftësinë e tyre.⁴ Në këtë kontekst, ekzistojnë disa mënyra të përgjithshme për të bërë një motivim pozitiv tek nxënësit në drejtim të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana e mësuesit. Disa nga këto mënyra janë:

Entuziazmi - Mendohet se entuziazmi shpreh rrezatim, dritë, shpresë, gëzim, motivim të cilat i duhen nxënësit për të ecur përpara në jetën shkollore, por jo vetëm shkollore, por edhe në jetë. Si fëmijët ashtu edhe të rriturit janë të frymëzuar nga entuziazmi i të tjerëve.⁵ Duke u nisur nga këto mendohet se mësuesit të cilët shprehin entuziazëm të vërtetë dhe interes në subjektin e tyre ka të ngjarë që të shprehin tek nxënësi një dëshirë për të mësuar e për të punuar. Nxënësi tek mësuesi duhet të shikoj dritën në fund të tunelit, e cila e udhëheq për të dalë nga errësira. Mësuesi duhet të

⁴ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/reviste-e-permuajshme-nr-21-viti-iiidhjetor-2013.pdf>

(Lexuar më 01.06.2020).

⁵ Korkmaz, i. “Motivimi ndaj nxënësit” Ankara 2002, f. 175-193.

jetë i aftë të infiltrohet në ndërgjegjen e nxënësit që të kuptojë emocionet, frikën, ngacmimet, pyetjet që lindin brenda tij, në mënyrë që ai ti njohë pikat e forta e të dobëta të nxënësit për të punuar mbi to dhe për të nxjerrë një rezultat të kënaqshëm. Angazhimi i mësuesit në punë është një nga mënyrat për të arritur motivimin. Shqetësimi për fëmijët se si gjenden ata në klasë do të demonstrojë angazhimin e mësuesit në punë. Ai duhet të gjejë kohë për të folur për interesat personale të nxënësit, për problemet e tij që ka brenda apo jashtë klasës, duke u bërë deri diku edhe një faktor i rëndësishëm për zgjidhjen e tyre. Zgjerimi i përgjegjësive të mësuesit përkundrejt këtyre problemeve ngjall interes të shtuar tek nxënësit, bën që ai ta ndjejë veten në qendër të vëmendjes, se gjithçka bëhet për t'i ardhur në ndihmë atij, por gjithmonë pa i kaluar caqet dhe rregullat që ka një shkollë. Reagimi i mësuesit kur jep vërejtje ka një ndikim të madh në motivimin e tyre, ndaj, nëse mësuesi do që nxënësi të përmirësohet, duhet të identifikojë pikat e tij të forta në mënyrë që të dijë si ta këshillojë, të jetë i qartë dhe konstruktiv në lidhje me ndonjë dobësi të nxënësit, të ofrojë mundësi se si nxënësi mund të përmirësohet me punën e tij, gjithmonë duke vlerësuar përpjekjet që ai bën.

Mirëkuptimi - Para së gjithash mësuesi duhet të jetë mirëkuptues ndaj nxënësve të tij. Të jetë gjithmonë i hapur dhe tolerant me ta, të dijë të analizojë sjelljet e tyre, dhe të mundohet t'i japë një zgjidhje sa më efektive. T'u tregojë nxënësve që përveç se mësues, ai di të jetë dhe një shok shumë i mirë, këshillues kur ata kanë nevojë.

Vlerësimi i mësuesit është jo më pak i rëndësishëm se mënyrat e tjera. Mësuesi duhet të nxisë nxënësin të japë mendimin apo opinionin e tij, lidhur me një temë ose diskutim që bëhet në klasë duke i treguar që ato do të vlerësohen nga ana juaj, duhet t'i japë nxënësit kohë në mënyrë që t'i ofrojë mundësinë që të reflektojë mbi gjërat e përvojat e tyre personale dhe ndjenjat e tyre mbi temën, të nxisë imagjinatën e nxënësve në mënyrë që të marrë përgjigje sa më afër temës së dhënë, gjithmonë duke vlerësuar përgjigjet e dhëna. Vlerësimi i mësuesit është shumë i rëndësishëm sidomos për ata nxënës që nuk marrin guximin të shprehen, qoftë edhe pse ata e dinë, por kanë frikë se mos gabojnë duke bërë një figurë të keqe para klasës e, sidomos

para mësuesit. Këta janë nxënës shumë emotiv dhe një vlerësim negativ nga ana e mësuesit do t'i mbyllte më shumë në vetvete, duke bërë që të mos shpreheshin më, ndaj mësuesi duhet të jetë shumë i kujdesshëm me këta nxënës dhe t'i vlerësoj përgjigjet e tyre në mënyrë të atillë që gjykimi mos t'u vrasë sedrën.

2.4. Komponentët kryesorë të motivimit

Në metodologjinë e mësimdhënies thuhet se komponentët kryesorë të motivimit të nxënësve janë:

- motivimi i brendshëm,
- motivimi i jashtëm, dhe
- shpresa për sukses.

Në këtë kontekst, motivimi i brendshëm ka të bëjë me shkallën në të cilën nxënësit merren me një veprimtari, me qëllim që të plotësojnë ose kënaqin kuriozitetin dhe interesin e tyre për një temë të caktuar në kuadër të një lënde. P.sh. ka disa nxënës të cilëve u pëlqen Historia apo Gjeografia, dhe ata punojnë shumë në atë lëndë. Ky është motiv i brendshëm.

Ndërkaq, motivi i jashtëm ka të bëjë me tërheqjen në një veprimtari me qëllim që të arrihen disa synime, të cilat shpërblehen, p.sh. lëvdata nga prindërit dhe mësuesit mund të jenë si lloje të stimulimit të jashtëm. Shembull: nëse një nxënës e do dhe interesohet për lëndën e Biologjisë (motiv i brendshëm) për të kjo lëndë është shumë e rëndësishme që të arrijë qëllimin në realizimin e dëshirës për profesionin e ardhshëm (motiv i jashtëm).

Kurse, shpresa për sukses, ka të bëjë me atë se çdo detyrë që i ngarkohet nxënësit duhet të jetë në përputhje me shkathtësitë psiko-fizike të tij, dhe ngarkesa në rangun e mbi mesatares së mundësive të nxënësit është e lehtë dhe e mundshme për të. Në procesin edukues, studiuesit e kanë parë motivimin e brendshëm dhe të jashtëm

bazuar në tre tipa që ndikojnë në fuqinë në tërësi të motivimit. Tri llojet e motivimit të brendshëm janë: *të dish*, i cili përkufizohet si një fakt për të performuar një aktivitet bazuar në kënaqësi të brendshme që individi merr gjatë të mësuarit dhe të eksploruarit. Motivimi i brendshëm bazuar *në arritje*, i cili ka të bëjë me realizimin e një veprimi bazuar në kënaqësi dhe në një eksperiencë të kënaqshme, ku individi përpiqet për të kryer apo për të krijuar diçka. Dhe lloji i tretë, i cili bazohet *në kënaqësinë* që është operative, kur dikush angazhohet në një aktivitet, në mënyrë që të përjetojë ndjenjat e stimuluar që kalojnë nga angazhimi në aktivitet.

Pra, nisur nga trajtimet e mësipërme shohim se motivimi si një forcë e brendshme nxitëse bazohet në dëshirën, kënaqësinë personale të gjithsecilit nga ne, ndërsa motivimi i jashtëm bazohet në stimujt e jashtëm, ku shpeshherë mospërmbushja e tyre ndikon dhe në uljen e kënaqësisë së brendshme të individit. Nëse kemi ulje të motivimit të jashtëm apo edhe të brendshëm, do të shihet dukshëm ulja e performancës në punën e gjithsecilit. Prandaj, motivimi dhe ndjenja e kënaqësisë në institucione të ndryshme ka një rëndësi të dukshme, pasi kënaqësia në punë dhe motivimi janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.⁶ Motivimi në nivele të kënaqshme ndikon drejtpërdrejt edhe në produktivitetin apo e thënë ndryshe, në performancën e punonjësve. Kënaqësia e lidhur ngushtë me nivelin e motivimit të punonjësve është e rëndësishme, pasi ndikon në besnikërinë e punonjësve, efikasitetin në vendin e punës dhe cilësinë e jetës dhe të tëra së bashku ndikojnë në performancën e tyre në tërësi.⁷ Puna në ditët e sotme është e ndryshme, e larmishme dhe vazhdimisht në ndryshim. Në institucionet shkollore niveli i faktorëve motivues të mësuesit është shumë i rëndësishëm, ai ndikon drejtpërdrejt në procesin mësimor në tërësi dhe në arritjet akademike të nxënësve. Në sajë të studimeve të ndryshme janë vënë re katër faktorë kryesorë ndikues në motivimin e mësimit të mësuesit: 1) faktori social, që nënkupton sjelljen dhe feedback-un e anëtarëve të tjerë të institucionit në tërësi dhe të komunitetit; 2) zëvendësuesi psikologjik, që nënkupton plotësimin e një nevoje, jo

⁶ Bush, T., Middlewood, D. (2013), "Leading and Managing People in Education"; Saga Publications, Inc. London; f. 78 Online ISBN: 9781446215753.

⁷ Swathi.B (2013) "Intervention research on working conditions and employee performance" International Monthly Refereed Journal of Research In Management & Technology, vol 2, f. 146-152.

duke u bazuar te kërkesa aktuale e nevojës, por duke e plotësuar këtë nevojë me diçka tjetër; 3) motivuesi bazë, që nënkupton plotësimin e nevojave bazë dhe 4) perceptimi i rezultateve.

Siç shihet, kemi të bëjmë me dy grupe në motivimin e brendshëm dhe të jashtëm, që ndikojnë në procesin e mësimdhënies së mësuesve. Studime të ndryshme kanë hulumtuar si motivimin e jashtëm, ashtu edhe atë brendshëm duke i trajtuar secilin më vete dhe duke i parë si faktorë parësorë në kryerjen e shumë aktiviteteve dhe veprimtarive. Shpesh janë bërë dhe diskutime ku studiues të ndryshëm kanë parë si parësor motivimin e brendshëm në kryerjen e veprimtarive jetësore dhe në rritjen e nivelit të performancës në punë. Gjithashtu, janë bërë studime të ndryshme ku këta faktorë (i jashtëm dhe i brendshëm) janë parë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Me rëndësi është të theksohet fakti që shpesh shpërblimet dhe përfitimet (faktor i jashtëm) mund të rrisin kënaqësinë e brendshme, por ka raste kur kjo kënaqësi na bën që të nxitemi nga stimuli i jashtëm, sado që ai mund të mos jetë tërheqës ose në përputhje me interesat tona.

Bazuar në studime dhe në literatura të ndryshme, motivimi është zhvilluar në katër hallka: (1) proceset bazë motivuese, (2) ndikimi i ngjarjeve të mëparshme në situatën e afërt të një personi, (3) lidhjet e rezultatit të motivimit dhe (4) influencat pjesërisht ekzogjene (të jashtme). Me këtë përkufizim të motivimit të lidhur me katër hallka kryesore nënkuptohet lidhja dhe ndikimi i forcës nxitëse së brendshmi dhe së jashtmi, ndërthurja e tyre në tërësi, si dhe ndikimi në performancën dhe produktivitetin e punës së punonjësve në institucionet, ku ata punojnë.⁸

⁸ Kanfer, R. Chen, G. Pritchard, R. (2008), Work Motivation: Forging New Perspectives and Directions in the Post-Millennium, Past, present and future” f. 2-3.

III. MËNYRA E MOTIVIMIT TË FËMIJËVE PËR RUAJTJEN E MJEDISIT JETËSOR

3.1. Motivimi mjedisor si pjesë e formimit të përgjithshëm

Me fjalën mjedis nënkuptojmë të gjitha gjërat që ndodhen rreth nesh, dhe me të cilat në mënyrë direkte apo indirekte është e lidhur jeta dhe veprimtaria e njeriut. Ai ka kuptim të njëjtë me ambientin, mjedisin jetësor, rrethin mjedisor apo natyrën. Të gjitha këto emërtime nënkuptojnë hapësirën në të cilën jetojmë. Çdo gjë që gjendet rreth nesh quhet mjedis. Ne jetojmë në këtë mjedis dhe jemi pjesë e këtij mjedisi. Mjedisi për ne ka krijuar shumë gjëra që ne të përfitojmë duke i shfrytëzuar të mirat e tij. Ai na dhuroi natyrën, ajrin, ujin, shtazët, bimët, pasurit nëntokësore, etj. Njeriu gjithmonë ka ndikuar në mjedisin jetësor dhe anasjelltas. Ai me ose pa vetëdije, duke i shfrytëzuar këto të mira, në të shumtën rasteve ndikon negativisht, gjegjësisht ndikon keq në pamjen dhe përbërjen e tij duke i hedhur mbeturinat në hapësira të hapura, duke e ndotur ajrin me gazra të ndryshme të dëmshme edhe për vetë njeriun, duke e ndotur ujin në mënyra të ndryshme, duke i shkatërruar pyjet, etj. Njeriu me veprimet e tij ka bërë që çdo element i mjedisit të dalë nga baraspesha. Si pasojë e zhvillimit të shpejtë të teknikës dhe industrisë, dhe shtrirjen globale në tërë planetin, janë shkaktuar çrregullime të mëdha mjedisore.

Nga ana tjetër, në shkollë kanë folur pak për këto probleme, e gjithashtu edhe në mjetet e informimit, kjo temë shumë e rëndësishme, fatkeqësisht zë një vend shumë të vogël dhe të parëndësishëm. Shumë pak flitet ose shkruhet për këto probleme tejet serioze, të cilat në të ardhmen, do të paraqesin një problem shumë të madh me përmasa globale për gjithë banorët e planetit tonë.⁹

⁹ http://ammk-rks.net/repository/docs/broshura_new.pdf (Abdullah Pirçe, zyrtar i lartë për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor, “Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor”, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, 2009, f. 4-5). Lexuar më 06.06.2020.

3.2. Motivimi mjedisor dhe rëndësia e tij

“Edukimi mjedisor është procesi i të mësuarit që rritë njohuritë dhe ndërgjegjësimin e njerëzve për mjedisin dhe sfidat lidhur me të, që zhvillon aftësitë e nevojshme dhe ekspertizën, që nxitë qëndrime, motive, dhe angazhime për të ndërmarrë vendime të informuara dhe veprime të përgjegjshme”.¹⁰

Nisur nga citimi i mësipërm kuptojmë se mbrojtja e mjedisit duhet të jetë dhe të mbetet qëllimi dhe detyra kryesore e gjeneratave të reja dhe shoqërisë në tërësi. Kështu, për të gjetur mjedisi vendin e tij, dhe gjeneratat e reja të kujdesen për mbrojtjen e tij, institucionet arsimore në bashkëpunim me institucionet tjera shtetërore, duhet të punojnë në procesin edukativo-arsimor, në mënyrë që niveli i vetëdijes te gjeneratat e reja të jetë sa më i lartë. Për këtë qëllim, duhet të fillohet të punohet me nxënësit e shkollave, e posaçërisht me nivele më të ulëta, të kontaktohen sa më tepër, me qëllim të ngritjes së edukimit dhe vetëdijesimit të tyre, qysh nga mosha e re, kur ata fillojnë të dinë për jetën.

Në këtë kontekst, edukimi mjedisor fokusohet në:

- Ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë në lidhje me mjedisin dhe sfidat mjedisore;
- Njohuritë dhe kuptimin në lidhje me mjedisin dhe sfidat mjedisore;
- Qëndrimin e interesuar për mjedisin dhe ndihmën për të ruajtur cilësinë e tij;
- Zhvillimin e aftësive për të zbutur problemet mjedisore;
- Pjesëmarrjen në projekte dhe programe mjedisore.

Pra, edukimi mjedisor, si term, nënkupton procesin e njohjes dhe të qartësimit të koncepteve, zhvillimin e aftësive dhe të qëndrimeve të caktuara, për të kuptuar dhe vlerësuar ndërveprimet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, kulturës së tij dhe mjedisit rrethues bio-fizik. Edukimi mjedisor synon rritjen e përgjegjësisë individuale në

¹⁰ UNESCO, Deklarata Tbilisi, 1978.

marrjen e vendimeve dhe formulimin e një kodi sjelljeje për çështjet që lidhen me cilësinë e mjedisit dhe ruajtjen e tij.

3.3. Shkolla si institucion kyç në motivimin mjedisor

Edukimi mjedisor fillon që me kontaktet tona të para me natyrën, e vazhdon më tej gjatë gjithë jetës. Edukimi mjedisor në shkollë bën ndërgjegjësimin e nxënësve për të gjitha llojet e shkatërrimeve dhe ndotjeve që po ndodhin sot në planetin tonë dhe ndaj të gjithë gjallesave të tij. Ai tregon rrugët e mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit dhe nxitë nxënësit të sillen dhe veprojnë në këto rrugë. Pra, edukimi mjedisor, duhet të nisë që në ciklin fillor dhe të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të nxënësve. Prandaj, shkolla është institucioni kyç që duhet t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë njohuritë e tyre mbi mjedisin, të kuptojnë mjedisin dhe të aftësohen në arsyetime e qëndrime të dobishme për sot dhe për nesër në jetën në mjedis.

Në këtë mënyrë, shkollat duhet të japin kontributin e tyre në edukimin mjedisor jo vetëm duke dhënë informacion të saktë rreth mjedisit, por edhe duke ndihmuar nxënësit të krijojnë projekte që realizohen në veprime të veçanta me qëllim që edukimi mjedisor përveç të tashmes, të theksojë edhe vizionin për të ardhmen. Mangësitë në këtë formim sjellin si pasojë egoizëm në shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe mjaft probleme mjedisore dhe sociale.¹¹

Në këtë kontekst, për të transmetuar këto njohuri dhe për të zhvilluar aftësitë, për të kultivuar vlerat dhe qëndrimet e nxënësve nga ana e mësuesit, gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve, përdoren një sërë metodash dhe teknikash në bashkëpunim me nxënësin. Këto metoda, të cilat kanë në thelb ndërveprimin, sigurojnë kushte që nxënësi të zotërojë informacion përmes një sërë procesesh, të cilat zhvillojnë aftësitë e nevojshme dhe të domosdoshme për edukimin mjedisor. Në

¹¹ Broda H. W. Schoolyard – Enriched Learning: “Using the Outdoors as an Instructional Tool”, (2007).

këtë këndvështrim, fëmijët kanë dëshirë të natyrshme për veprimtari fizike dhe dalje në natyrë dhe, për vetë natyrën e tij, edukimi mjedisor, përmes aktiviteteve në “ajër të pastër” është një element i rëndësishëm i mësimin. Aktivitetet që zhvillohen në mjedis të hapur si shëtitjet, ekskursionet, lojërat në natyrë dhe eksperimentet, puna vullnetare, kampet verore, etj., rrisin ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e fëmijëve për mjedisin që i rrethon.¹²

Kështu, zhvillimi i kuptimit të mjedisit dhe qëndrueshmërisë së tij, varet nga vullneti i nxënësve dhe i aftësisë së tyre për të bërë pyetje për botën përreth duke kërkuar informacionin e duhur në mënyrë që t’u japin përgjigje pyetjeve të tyre. Mbledhja e këtij informacioni mbi problemet mjedisore kërkon një familjaritet me mënyrat bazë të vëzhgimit, një zotërim të aftësive themelore për mbledhjen, organizimin, interpretimin, sintetizimin dhe vlerësimin e informacionit, zhvillimin e shpjegimeve dhe komunikimin e këtyre kuptimeve tek të tjerët.¹³

Nga ana tjetër, nxënësit duhet të kenë dhe të demonstrojnë një kuptim të plotë rreth mjedisit natyror dhe marrëdhënieve të brendshme që ekzistojnë midis sistemeve natyrore dhe ndërlidhjes së njeriut me to. Themeli i edukimit mjedisor është kuptimi i proceseve të bashkëveprimit të sistemeve që përbëjnë mjedisin. Prandaj, thelbësore është që nxënësit të kenë njohuri rreth tokës si një sistem jetësor, dinamik, fizik, i cili ndikohet nga shoqëritë e ndryshme njerëzore. Këto njohuri janë domosdoshmëri dhe parakusht për zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe planifikimin e aktiviteteve të nevojshme si përgjigje e individëve dhe komunitetit ndaj çështjeve mjedisore.¹⁴ Këto njohuri, nga ana tjetër, i pajisin nxënësit me mundësi për të zbatuar dhe përmirësuar kapacitetin e tyre për sistemet e të menduarit dhe të kuptuarit të një bote e shoqërie të qëndrueshme. Fokusimi në çështjet e mjedisit i ofron nxënësve një mënyrë për të integruar njohuritë e tyre mbi sistemet shoqërore dhe mjedisore, të nxisin abstragimin, novacionin dhe krijimtarinë.

¹² http://documents.rec.org/offices/projects/4_outdoor_teacher_guide_web.pdf. “Udhëzues për mësimin në realizimin e edukimit mjedisor jashtë mureve të shkollës”. Lexuar më 06.06.2020.

¹³ Johnson B, Christensen L. Educational research: Quantitative, qualitative, and mixed approaches. Thousand Oaks, CA: Sage Publications, (2012).

¹⁴ Christiansen J, Christianson D. Environment, Energy, resources, (2006).

3.4. Mënyrat e motivimit të nxënësve për ruajtjen e mjedisit

Nxënësit në klasat ku zhvillohen veprimtaritë e edukimit mjedisor mësojnë dhe nxënë më mirë atëherë kur janë të motivuar. Kjo ndodh atëherë kur ata:

- Janë të qartë për veprimtaritë që po kryejnë dhe qëllimin që ato kanë;
- Mund të punojnë vetë duke u mbështetur në njohuritë që ata vetë kanë;
- Marrin pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të veprimtarive duke i krijuar hapësirë që të përdorin gjuhën dhe perceptimet e tyre për të kuptuar.

Përveç kësaj, nxënësit që marrin pjesë në këto veprimtari do të përfshiheshin më aktivisht në veprimtaritë e zhvilluara në qoftë se ata:

- Kanë një mjedis të përshtatshëm dhe i siguron mundësi të punojnë së bashku me të tjerët dhe po ashtu e çliron nga presioni i notës apo i gabimit;
- Kanë një sërë mundësi zgjedhjesh për çfarë, kur dhe si duan të mësojnë;
- Kanë kohë të mendojnë dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar.¹⁵

3.5. Objektivat dhe metodat e motivimit mjedisor

Nxënësit, si qytetarë të shoqërisë së sotme dhe asaj të ardhshme, pritet të marrin vendime dhe të kenë aftësi veprimi për të kontribuar në qëndrueshmërinë mjedisore. Përveç kësaj, këto njohuri i mundësojnë ato të analizojnë efektivitetin e veprimeve individuale kundrejt atyre në grup, të bëjnë zbërthimin e planeve që përfshijnë

¹⁵ http://ammk-rks.net/repository/docs/broshura_new.pdf (Abdullah Pirçe, zyrtar i lartë për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor, “Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor”, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, 2009, f. 26-27). (Lexuar më 06.06.2020).

pjesëmarrjen e qytetarëve dhe t'i përshtatin këto plane në kushtet specifike sociale, kulturore, pasojat dhe ndikimet mbi mjedisin e vendit ku jetojnë.¹⁶

Njohuritë për mjedisin që nxënësit kanë marrë nga materiale të ndryshme në shkollë i ndihmojnë të kuptojnë sesi ndikojnë sjelljet e tyre mbi mjedisin. Në përfundim të arsimit parauniversitar, nxënësit duhet të kenë njohuritë, aftësitë dhe besimin për të vepruar në mënyrë të pavarur lidhur me ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Pjesëmarrja e tyre në aktivitete ndihmon drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e sfidave mjedisore.

Objektivat e përgjithshme të edukimit mjedisor në shkollë synojnë që nxënësit të jenë të aftë:

1. Të njohin faktorët e ndryshëm që ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në mjedis;
2. Të kuptojnë se njeriu ndikon gjerësisht mbi mjedisin në shkallë vendore, kombëtare dhe më tej;
3. Të jenë të përgatitur për të analizuar informacionin mjedisor duke mbajtur qëndrim kritik ndaj tij;
4. Të aftësohen për të përshkruar sistemet ekologjike dhe mjedisore dhe të vlerësojnë ndërveprime ndërmjet sistemeve;
5. Të aftësohen për të nxjerrë konkluzione nga vëzhgimet individuale apo analizat e materialeve të ndryshme burimore, për të gjetur zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e mjedisit;
6. Të aftësohen për të punuar në grupe pune për të zhvilluar një veprimtari të dobishme mjedisore;
7. Të zhvillojnë ndjeshmërinë për problemet e mjedisit human dhe natyror, dhe aftësinë për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve komplekse mjedisore.¹⁷

¹⁶ Balzano E, Miele C, Serpico M. Citizen Science and Environmental Education in Italy. Possible Developments and the Role of Universities, (2016); f 6.

¹⁷ Instituti i Kurrikules dhe Trajnimit & UNICEF. Edukimi Mjedisor për ciklin fillor. Libri i mësuesit, (2008); f 6,12,14.

Nga ana tjetër, përgjithësisht është pranuar se pedagogjia tradicionale, e cila e trajton nxënësin si marrës pasiv të informacionit, njohurive dhe fakteve nuk është e mjaftueshme për të ndryshuar mënyrat e të sjellurit dhe të menduarit në përgjithësi dhe edukimin mjedisor në veçanti. Praktika mësimore në edukimin mjedisor ka treguar se nxënësit janë shumë më të kënaqur dhe të interesuar ndaj të mësuarit konkret dhe praktik, në situata të vërteta jetësore. Përfshirja në mësim e aktiviteteve që bazohen në nxitjen e ndjenjave siç janë përfytyrimet e udhëzuara, dramatizimet, loja me role, meditimet, shplodhjet në natyrë, janë shumë efektive në edukimin mjedisor të nxënësve në shkollën fillore. Ekskursionet në natyrë nxitin kontaktet me natyrën, dhe dashurinë për të. Tregimi i historive në veçanti për kafshët është shumë efektiv për nxitjen e një mënyre qytetare të mbrojtjes së mjedisit.¹⁸ Kështu, edukimi mjedisor me synim ndryshimin e sjelljeve të nxënësve në drejtim të parashikuar e të paramenduar, kërkon përpjekje drejt strategjive efektive të tilla si përgatitje e posterave, fletë-palosjeve, eseve, krijimeve në pikturë etj., me temë nga mjedisi. Përfshirja e nxënësve në veprimtari të drejtuara në zgjidhjen e problemeve, të vendosura nga vetë ata, si tubimet, letrat drejtuar drejtuesve lokalë, aksionet për përmirësimin e mjedisit etj., janë metoda që nxisin pajisjen e nxënësve me kompetencën e veprimit mjedisor. Mësuesit, mund të përzgjedhin ato metoda apo teknika të cilat nxisin diskutimin, debatin, refleksionin apo vlerësimin e situatave dhe në përshtatje me moshën e nxënësve. Në tërësinë e metodave dhe teknikave përmendim disa prej tyre, të tilla si situatat e rastit, loja në role, demonstrimi, fotot, posterat, kolazhet, tregimet, historitë, etj., për të vetmen arsye se përdorimi i tyre përmbush më së miri pritshmërinë e mësuesve për trajtimin e problematikave të ndryshme mjedisore. Kjo nuk i privon aspak mësuesit nga liria për të përdorur metodën, teknikën apo për të hartuar strategjinë që ata konsiderojnë si më efektiven, në kushtet konkrete të klasës që punojnë.¹⁹

¹⁸ Scott P. Environmental education in the schools. Creating a program that works, (1993); f 42.

¹⁹ Mastori E. Vlerësimi i Edukimit Mjedisor në shkollë. Manual për Edukimin Mjedisor. Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, (2009).

3.6. Pesë parime të motivimit mjedisor për mësimdhënien jashtë shkollës

Për sa u takon parimeve të cilat mund të ndiqen nga çdo mësimdhënës, kur bën shëtitje apo ekskursion me fëmijët, me qëllim të edukimit mjedisor në natyrë, mund të përmendim pesë nga këto parime, të cilat janë:

1) Mëso më pak dhe ndaj shumë

Kur u tregon fëmijëve fakte të ndryshme nga natyra, është më mirë t'u tregosh atyre dhe për ndjenjat e tua në prani të një peme, luleje etj. T'u tregosh atyre për frikën dhe respektin tënd se si një pemë mund të rritet në kushte nënalpine, ku uji është i pakët në verë dhe pothuajse i ngrirë në dimër; ku erërat e forta mund të thyejnë degët e pemës, gjithashtu mund t'u tregosh se sa e çuditshme është që rrënjët e një pise gjejnë mundësi për t'u ushqyer dhe për të mbijetuar në shkëmbinj. Fëmijët u përgjigjen këtyre vëzhgimeve më me lehtësi se informacioni i teksteve mësimore që e shpjegon atë, p.sh. mund të marrësh shembullin e një peme pise që rritet në një kamp afër një zone natyrore. Është e rëndësishme që një i rritur të ndajë me fëmijët ndjenjat e tij. Vetëm duke ndarë me ta këto ndjenja, ne komunikojmë dhe i ngjallim të tjerëve dashurinë për natyrën dhe tokën. Kur ne ndajmë me fëmijët idetë dhe ndjenjat tona, e nxisim atë që të eksplorojë ndjenjat dhe perceptimin e tij, dhe të zhvillohet një besim dhe miqësi e përbashkët ndërmjet të rriturit dhe fëmijës.

2) Të jesh perceptues

Perceptues do të thotë të dëgjosh dhe të jesh i informuar. Është një nga qëndrimet më të vlerësuara që mund të kultivohet gjatë punës me fëmijët. Të qenit jashtë, sjell një entuziazëm spontan tek fëmijët që, mësimdhënësit me zotësi, mund t'i drejtojnë drejt mësimi. Të bërit i arsyeshëm: çdo pyetje, çdo koment, çdo thirrje gëzimi është një mundësi për të komunikuar, dhe përgjigja ndaj interesit të fëmijëve dhe kuriozitetit të tyre. duke respektuar mendimet e tyre, bën që të jeni më pranë.

3) Fokusimi shpejtë në vëmendjen e fëmijëve

Që në fillim trego qëllimin e ekskursionit. Përfshiji fëmijët sa më shumë të jetë e mundur, duke u bërë pyetje dhe duke u treguar atyre pamje dhe zhurma interesante. Disa fëmijë nuk janë të interesuar për të parë më nga afër natyrën kështu që, gjej gjëra interesante për ta dhe udhëhiqi pak e nga pak drejt një vëzhgimi më të kujdesshëm. Bëji të mendojnë se ajo çka ata kanë gjetur është me interes për ju.

4) Shiko dhe përjeto në fillim, fol më vonë

Nuk është e nevojshme që të fokusohemi në gjëra të jashtëzakonshme, edhe gjërat e zakonshme mund të japin diçka të bukur kur shikohen me kujdes. Fëmijët kanë aftësi për të bërë për vete çdo gjë që shikojnë. Fëmijët i kuptojnë më mirë gjërat kur ata bëhen njësh me to, se sa kur dikush tjetër ua shpjegon brenda mureve të klasës. Ata vështirë se harrojnë një përvojë në natyrë. Mos u ndjeni keq (si mësues) nëse nuk dini emrat e bimëve dhe të kafshëve, ato janë emërtime sipërfaqësore. Për shembull, ju mund të pëlqeni më shumë një dru lisi, nëse e shikoni se si ai ndryshon gjatë gjithë ditës kur mbi të bie drita. Shikojeni pemën nga perspektiva të pazakonta. Nuhasni dhe ndjeni gjethet dhe lëvoren e tij. Uluni ose qëndroni poshtë pemës dhe shikoni me kujdes të gjitha llojet e formave jetësore që jetojnë dhe janë të varura prej tij. Vështro, bëj pyetje, hamendëso dhe argëtohu.

5) Një sens gëzimi duhet të përshkojë eksperiencën

Fëmijët mësojnë më mirë nëse ju mund ta mbani gjallë gëzimin dhe entuziazmin e rastit. Mos harro se entuziazmi juaj është ngjites dhe ndoshta, vlera juaj më e madhe si mësues²⁰

²⁰ http://documents.rec.org/offices/projects/4_outdoor_teacher_guide_web.pdf. “Udhëzues për mësuesit në realizimin e edukimit mjedisor jashtë mureve të shkollës”. (Lexuar më 06.06.2020).

3.7. Koncepti i motivimit dhe edukimit mjedisor sipas studiuesve të huaj

Nevoja për të kuadruar konceptin e edukimit mjedisor duket një sfidë për shumë studiues të huaj. Shumëllojshmëria e ndryshoreve dhe gama e fushave e bëjnë interpretimin e konceptit jo të thjeshtë dhe të lehtë.

Stevenson shprehimisht thotë: “Kur ne flasim për edukimin për mjedisin, ne nënkuptojmë që edukimi duhet të përqipet të jetë për diçka të huaj për vetë edukimin. Nëse duam që nxënësit të ekzaminojnë ideologji, të kritikojnë dijen tradicionale dhe të marrin pjesë në kritika kulturore dhe rindërtime, atëherë duhet të pranojmë që ata edhe mund të mohojnë qëllimin që është zgjedhur për ta. Nëse duam me të vërtetë që të hapim mendjen e nxënësve për të alternuar pikëpamje të ndryshme për botën, atëherë nuk ka kuptim t’i orientojmë ata drejt një vizioni të caktuar”.²¹ Më tej, ai thekson se: “edukimi mjedisor duhet të përfshihet dhe të jetë pjesë e disiplinave të tjera të kurrikulës formale të edukimit në të gjitha nivelet, në mënyrë që të nxisë ndjenjën e përgjegjësisë për mjedisin dhe t’u mësojë nxënësve si ta vëzhgojnë, si ta mbrojnë dhe përmirësojnë atë”.²² Ndërkaq, sipas Sipas Braus dhe Wood: “edukimi mjedisor është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me vlerat njerëzore. Kur një fëmijë rritet me vlerat njerëzore që ai ka marrë gjatë edukimit, i pasqyron në të gjitha zgjedhjet që bën, përfshirë edhe zgjedhjet për mjedisin”.²³ Kurse, sipas Marsden: “qëllimi i edukimit mjedisor është të lidhë fëmijët me tokën dhe mjedisin natyror, jo vetëm me njohuritë të cilat do t’i bindin ata për nevojën e mbrojtjes së mjedisit, por edhe me anë të ekskursioneve në natyrë, në mënyrë që nxënësit të ndiejnë përfshirjen e tyre në mjedisin natyror si një burim estetik kënaqësie”.²⁴

²¹ Stevenson R.B. Environmental Education, (1987) ; f. 95.

²² Po aty., 98.

²³ Braus J, Wood D, Environmental Education in the schools, (1993); f. 24..

²⁴ Marsden B. Why care for nature, (1997) : f. 12.

IV. FAKTORËT NDOTËS DHE MBROJTJA E MJEDISIT

4.1. Ndotja e mjedisit

Sot mjedisi ynë është i sulmuar nga shumë ndotës. Këta ndotës ndikojnë në të gjitha pjesët e mjedisit dhe në të gjithë botën e gjallë, dhe jo të gjallë, duke lënë ndonjëherë pasoja shumë të mëdha. Qeniet e gjalla si njeriu, shtazët dhe bimët, shumë më vështirë lirohen nga këto ndotje se sa ajri, uji apo toka. Nga ana tjetër, edhe vet njeriu e ndihmon në masë të madhe përkeqësimin e kësaj situatë edhe ashtu të vështirë, me përdorimin e duhanit, alkoolit, drogës dhe helmeve tjera, si dhe me aktivitete të ndryshme që i ndërmerr për nevojat e veta personale apo kolektive.

Kështu, ndotja paraqet hedhjen e materialit kontaminues (ndotës) në mjedis. Ajo shkaktohet kryesisht nga aktivitetet e njeriut, por gjithashtu mund të jetë rezultat i fatkeqësive natyrore. Ndotja ka ndikim dëmtes në çfarëdo organizmash të gjallë në mjedis, duke e bërë praktikisht të pamundur qëndrueshmërinë e jetës.

4.2. Ndotja e Tokës

Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore.

Toka ku ne jetojmë dhe zhvillojmë veprimtaritë tona, është mjaft e rëndësishme. Pa të nuk mund të ketë jetë, ashtu si dhe uji. Toka është e rrezikuar nga ndotja. Te njëjtët faktorë që ndotin ujin e ajrin, e ndotin edhe tokën. Nga ana tjetër, toka është e rrezikuar edhe nga humbja e shtresës së sipërme që përdoret prej njeriut për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë. Humbja e saj vjen nga fenomeni i shpyllëzimit, erozionit, ndryshimit të temperaturave etj. Kurse, mënyra më e mirë për të

parandaluar ndotjen e tokës është përmes menaxhimit të mbeturinave në mënyrë adekuate, shfrytëzimit të tokës në mënyrë adekuate dhe praktikave adekuate bujqësore.

4.3. Ndotja e ujit

Ndotja e ujit paraqet hedhjen e materieve kimike, biologjike dhe fizike nëpër sasi të mëdha të ujit, të cilat materie shkatërrojnë cilësinë e gjallesave në të dhe që e shpenzojnë atë.

Uji është një nga elementet kryesore për jetën e njeriut, pasi nëpërmjet tij ne gatujmë, pastrojmë etj. Industria dhe bujqësia janë konsumatorë të mëdhenj të ujit. Burimet ujore, po preken si nga faktorët shoqërorë, ashtu edhe nga faktorët natyrore. Nder faktorët natyrore janë: kalimi i ujit në sipërfaqe ose në thellësi, duke u përzier me ujërat e ndotura etj. Nder faktorët shoqërorë, mund të përmendim ndotjen që vjen nga përdorimi i kimikateve, derdhjen e mbeturinave, derdhja e naftës etj. Ndotja e ujit sjell pasoja të rënda për jetën siç është zhdukja e gjallesave të ndryshme të ujit, mospërdorimi për nevojat jetike, përhapja e sëmundjeve infektive etj.

4.4. Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit paraqet grumbullimin e atyre substancave të rrezikshme në atmosferë të cilat substanca rrezikojnë jetën e njerëzve dhe të gjallesave të tjera.

Zhvillimi i industrisë dhe përdorimi i makinave bën që ajri të cilin ne thithim të jetë mjaft i ndotur, sidomos në zonat urbane ku është e përqendruar edhe popullsia me e madhe. Ajri që ne thithim është i mbushur me elemente të rrezikshme për jetën si CO₂ etj. Kjo ka bërë që të shfaqen një numër i madh sëmundjesh me rrezik të lartë

për jetën si p.sh. llojet e ndryshme të kancerit. Ndotja e ajrit është e ndryshme në ambiente të ndryshme. Ka disa mjedise pune si në shkrirjen e metaleve, në degë të industrisë, ku përdoren kimikate etj., dhe ku shkalla e ndotjes së ajrit është shumë e lartë dhe rrezikon shëndetin e punëtorëve, dhe të banoreve përreth. Burimet kryesore që kanë ndikuar në rritjen e ndotjes së ajrit janë: djegia e mjeteve të transportit, dhe djegia pa rregulla e mbeturinave.²⁵

4.5. Mbrojtja e mjedisit

Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jo biotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë: mjedisin biofizik, natyror të ajrit, tokës, ujërave; shëndeti në njeriut, vlerat dhe trashëgiminë kulturore, shkencore, fetare dhe shoqërore. Pra, mjedisi është një bashkëveprimi faktorëve natyrorë dhe shoqërorë.

Faktorët natyrorë dhe shoqërorë të mjedisit ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njeriut. Ata janë një kusht thelbësor për të përcaktuar zhvillimin fizik, mendor, intelektual, psikologjik, si dhe vetë mënyrën e jetesës së tij. Për ta konkretizuar këtë mjafton të krahasojmë dy njerëz që jetojnë në mjedise të ndryshme p.sh: një njeri që jeton në një zonë të qetë, ku ka shumë gjelbërim dhe ajër të pastër dhe një tjetër, i cili jeton në një mjedis të zhurmshëm, të ndotur dhe pa gjelbërimin e duhur. Që këtu fillon ndryshimi. Personi i cili jeton në mjedis të pastër dhe të qetë, është i shëndetshëm dhe ka më pak stres, në krahasim me atë që jeton çdo ditë nën smogun e pluhurit dhe mes jetës intensive të një zone të industrializuar.

Për t'i mbijetuar kohës, njeriut i është dashur t'i përshtatet mjedisit ku jeton dhe ta ndryshojë atë në mënyrë që ta bëjë më të përshtatshëm për ekzistencën e vet. Por pikërisht në këtë pikë shfaqen dhe problemet e para të mjedisit. Kështu, përparimi,

²⁵ <https://arditah.weebly.com/ndotja-dhe-mbrojtja-e-mjedisit.html>. (Lexuar më 05.07.2020).

zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë, por nga ana tjetër shfrytëzimi pa kriter i mjedisit, të gjitha këto krijuan dhe problemet e para midis njeriut e mjedisit. Zhvillimi i teknologjisë bëri që, vërtet, jeta të përmirësohet dhe njerëzit të jetojnë më mirë, por, nga ana tjetër, sollti edhe shumë probleme për mjedisin, siç është p.sh.: ndotja e ajrit, prerja e pyjeve etj.

Mjedisi është shumë i rëndësishëm, por shëndeti është kushti themelor për mirëqenien dhe veprimtarinë e njeriut. Për të pasur një shëndet të mirë, nuk mjafton vetëm kujdesi për veten, por është i nevojshëm edhe një mjedis i pastër i shëndetshëm. Për këtë arsye duhet të jemi të kujdesshëm me veprimet tona dhe duhet të kemi parasysh:

- Mbrojtjen e mjedisit, si një përgjegjësi shoqërore dhe individuale;
- Shfrytëzimin e burimeve natyrore nga shoqëria;
- Menaxhimin e burimeve të ripërtërishme;
- Burimet e pa ripërtërishme;
- Problemet që kanë të bëjnë me burimet ujore sot;
- Problemet që lidhen me tokën;
- Ndotjen e ajrit.²⁶

²⁶ <http://www.vet.al/files/projekte/MJEDISI.pdf>. (Lexuar më 05.07.2020).

V. METODOLOGJIA

Gjatë këtij punimi të diplomës janë analizuar përgjigjet e nxënësve në këto shkolla gjegjëse: SHFMU “Abdullah Shabani”, ”Gj. K. Skënderbeu”, ”Harun Beka” të komunës së Mitrovicës, dhe gjatë hulumtimit është identifikuar se sa ndikon motivimi në ruajtjen e mjedisit nga ana e nxënësve.

Ky hulumtim ka për synim të analizojë temën “Mënyra e motivimit të fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor”, dhe për të arritur deri në përfundim ky hulumtim përqendrohet në analizimin e disa pyetjeve kërkimore si :

1. A ndikon njeriu në ruajtjen e mjedisit?
2. A ndikon klasifikimi i mbeturinave në ruajtjen e ambientit?
3. Sa ndikon qarkullimi urban dhe lëvizja e motoçikletave në ndotjen e ajrit?

5.1. Hipotezat

Gjithashtu, ky punim provon t’u përgjigjet edhe hipotezave të punimit të cilat janë:

H1: Sa më i madh të jetë kujdesi i njeriut aq më pastër do të jetë mjedisi.

H2: Klasifikimi i mbeturinave sigurisht që ndikon në ruajtjen e ambientit.

H3: Qarkullimi urban dhe lëvizja e motoçikletave ndikon drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit.

5.2. Pjesëmarrësit

Në këtë punim është analizuar mënyra e motivimit të fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor, ku pjesëmarrës të këtij hulumtimi kanë qenë nxënësit e klasave të dyta të shkollës fillore “Abdullah Shabani” në Mitrovicë, SHFMU “GJ. K. Skënderbeu”, Mitrovicë - Vaganicë dhe nxënësit nga SHFMU “Harun Beka”, Mitrovicë - Gushavc (paralele e ndarë në fshatin Vidimriq të komunës së Mitrovicës).

Të dhënat personale të nxënësve kanë qenë anonime, për arsye që nxënësit të ndihen më të lirshëm gjatë përgjigjeve të tyre, dhe ky anonimitet nuk ka luajtur ndonjë rol gjatë hulumtimit. Në hulumtim kanë marrë pjesë 60 nxënës, ku 33 prej tyre kanë qenë të gjinisë femërore dhe 27 të gjinisë mashkullore.

5.3. Instrumenti

Instrumenti i cili është përdorur për të arritur rezultate në hulumtim, ka qenë përmes intervistës, ku ka pasur pyetje të hapura dhe pyetje me alternativa, lidhur me temën. Krahas tyre ka qenë një pyetje demografike ku është identifikuar gjinia e tyre. Mostër e këtij hulumtimi kanë qenë nxënësit e klasës së dytë.

5.4. Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Për analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve, është përdorur metoda kualitative. Fillimisht është kërkuar leje nga mësuesit që të na mundësohej t'i intervistojmë nxënësit e tyre, dhe më pas secili nxënës është intervistuar me pyetje të hapura dhe përgjigjet e tyre janë incizuar, dhe pastaj janë përdorur për të arritur rezultate në hulumtim.

Metoda cilësore është përdorur pra, me qëllim që të marrim rezultate sa më të sakta, dhe që hulumtimi të jetë sa më i besueshëm.


5.5. Analizat

Të dhënat janë marrë nga nxënësit e klasave të dyta në shkollat fillore të komunës së Mitrovicës. Këto të dhëna janë analizuar në mënyrë cilësore, përderisa përgjigjet e tyre janë marrë përmes intervistës.


5.6. Aspekti etik

Për të arritur përfundimin e këtij punimi, së pari kam siguruar lejen nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë për realizimin e intervistës nëpër shkollat fillore të Mitrovicës, e po ashtu, edhe të dhënat e nxënësve. Për të siguruar që nxënësit të ndihen më të lirë dhe më të sigurt në përdorimin e të dhënave të tyre, te dhënat personale të nxënësve janë mbajtur anonime.


VI. REZULTATET




Grafikoni 1. Pëqindja e nxënësve meshkuj dhe femra




Grafikoni 2. Format e ndotjes së shkaktuar nga njeriu



Grafikoni 3. Ndotësit e atmosferës




Grafikoni 4. Ndotësit e ujit




Grafikoni 5. Veprimet që ndikojnë në ndotjen e ujit




Grafikoni 6. Shkaktarët që ndikojnë në ndotjen e atmosferës-ajrit




Grafikoni 7. Niveli i pastërtisë së mjedisit jetësor



Grafikoni 8. Niveli i pastërtisë së mjedisit mësitor



Grafikoni 9. Ndotësi më i madh i ambientit



Grafikoni 10. Ndikimi i njeriut në ruajtjen e mjedisit



Grafikoni 11. Veprimet për ruajtjen e tokës

VII. DISKUTIMI

Ky punim diplome analizoi dhe diskutoi mënyrat e motivimit të fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor. Duke u bazuar në disa pyetje hulumtuese dhe hipoteza, u mundam të sjellim rezultate që u përgjigjen pyetjeve të parashtruara në fillim. Si pyetje kërkimore ka qenë se, a ndikon njeriu në ruajtjen e mjedisit, dhe si hipotezë është dhënë, se sa më i madh të jetë kujdesi i njeriut, aq më i pastër do të jetë mjedisi, dhe se në bazë të rezultateve të nxjerra nga pyetësi, është vërtetuar se njeriu ndikon në ruajtjen e mjedisit, andaj dhe mbështetet hipoteza e dhënë, sepse në pyetjen e pyetësorit se a ndikon faktori njeri në ruajtjen e mjedisit, të gjithë nxënësit kanë pohuar se njeriu ndikon në ruajtjen e një ambienti të pastër.

Po ashtu, edhe rezultatet e pyetjes, se a ndikon klasifikimi i mbeturinave në ruajtjen e ambientit, dëshmojnë edhe më shumë se nxënësit janë të informuar, duke dhënë përgjigje të gjithë se klasifikimi i qelqit, plastikës, letrës e metalit, ndikon në ruajtjen e mjedisit, dhe kjo i përgjigjet pyetjes hulumtuese të parashtruar në fillim, dhe mbështet hipotezën se klasifikimi i mbeturinave sigurisht se ndikon në ruajtjen e ambientit.

Për të kuptuar interesimin e fëmijëve në këtë temë akoma më shumë, parashtruam pyetjen për ndotjen nga trafiku, dhe rezultatet e pyetësorit kanë vërtetuar se qarkullimi urban dhe lëvizja e motoçikletave, ndikon drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit.

Gjatë hulumtimit tonë me nxënës në shkollat fillore "Abdullah Shabani", "Gj. K. Skënderbeu", "Harun Beka", kemi arritur të sigurojmë të dhëna në lidhje me instrumentin e përgatitur, pra përmes intervistës për nxënësit e klasave të dyta, dhe këto rezultate janë të paraqitura përmes pyetësorit në vijim:

1. Format e ndotjes së shkaktuar nga njeriu?

Gjatë intervistës me nxënës, 30 prej tyre thanë se format e ndotjes së shkaktuar nga njeriu janë ndotja e ajrit, 20 thanë se është ndotja e ujit dhe 10 u përgjigjën për ndotjen e tokës. Rezultat i paraqitur në grafikoni 2.

2. Cilët janë ndotësit e atmosferës?

Nga përgjigjet e nxënësve është identifikuar se nxënësit kanë njohuri për ndotjen e ajrit, duke u përgjigjur të gjithë, se shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit janë industria, transporti dhe lëndët djegëse. Kështu, 40 nga ta u pajtuan se ndotësi më i madh është transporti, kurse 20 u përgjigjën për industrinë dhe lëndët djegëse. Rezultat i paraqitur në grafikoni 3.

3. Kush janë ndotësit e ujit?

Përgjigjet e nxënësve pothuajse ishin të dyanshme. 31 prej tyre u përgjigjën se, ndotës të ujit janë mbeturinat, ujërat e zeza, kurse 29 prej tyre u përgjigjën se vetëm mbeturinat janë ndotës të ujit. Rezultat i paraqitur në grafikoni 4.

4. Cilat janë veprimet që ndikojnë në ndotjen e ujit?

Jo të gjithë nxënësit e patën të lehtë përgjigjen në këtë pyetje. Në këtë rast, vetëm 16 prej tyre janë përgjigjur, duke dhënë si përgjigje përdorimin e detergjenteve, kurse 44 të tjerë nuk dhanë përgjigje adekuate. Rezultat i paraqitur në grafikoni 5.

5. Cilët janë shkaktarët që ndikojnë në ndotjen e atmosferës-ajrit?

Të gjithë nxënësit u përgjigjën duke dhënë si përgjigje qarkullimin urban dhe lëvizjen me motoçikleta si ndotje të ajrit, pra duke dhënë përgjigje me nga dy opsione. Trafiku ajror nuk është dhënë si përgjigje nga asnjë nxënës. Rezultat i paraqitur në grafikoni 6.

6. Si e vlerësoni mjedisin ku ju jetoni?

Përgjigjet e nxënësve treguan se ata janë të kënaqur me mjedisin e shtëpisë, duke e vlerësuar si një ambient të pastër, dhe që të gjithë (60) u pajtuan se ambienti në të cilin jetojnë është i pastër. Rezultat i paraqitur në grafikonin 7.

7. Si e vlerësoni mjedisin ku ju mësoni?

Shumica e nxënësve (45 prej tyre) janë përgjigjur se në klasë vlerësojnë të jetë një ambient i pastër, po ashtu edhe në shkollë në përgjithësi, kurse të tjerët (15 prej tyre) kanë shprehur pakënaqësi për ambientin shkollor, duke cekur tualetet si një nga ambientet e papastra të shkollës, dhe të lëna pas dore, pa pastrim të rregullt. Rezultat i paraqitur në grafikonin 8.

8. Kush është ndotësi më i madh i ambientit?

Te gjithë nxënësit (60) gjatë intervistës kishin të njëjtin mendim se, njeriu është ndotësi më i madh i ambientit. Rezultat i paraqitur në grafikonin 9.

9. A ndikon njeriu në ruajtjen e mjedisit?

Secili nxënës ishte i vetëdijshëm se ruajtja e mjedisit së pari ndikohet nga kujdesi i njeriut, dhe se, sa më i madh të jetë kujdesi i njeriut ndaj natyrës, aq më i pastër është ambienti. Në këtë rast, pyetja ishte e hapur me përgjigje më të zgjeruar. Rezultat i paraqitur në grafikonin 10.

10. Cilat janë veprimet për ruajtjen e tokës?

Përgjigjet e nxënësve treguan se janë të njoftuar që klasifikimi i mbeturinave si (qelq, plastikë, letra, metal), janë veprimet e duhura për ruajtjen e tokës. Kështu, 50 nga ta u përgjigjën për klasifikimin e mbeturinave, ndërsa 20 të tjerët për riciklimin e tyre. Rezultat i paraqitur në grafikonin 11.

VIII. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si përfundim, duke u bazuar në konkluzionet e dalta nga ky punim do të jepnim këto rekomandime:

1. Rekomandim në radhë të parë prindërve për përfshirje sa më të madhe në kujdesin ndaj informimit të fëmijëve të tyre për një mjedis te pastër;

2. Në radhë të dytë, Ministrisë së Arsimit, mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave që të përpilojnë një lëndë të veçantë zgjedhore për edukimin mjedisor, për t'i motivuar sa më tepër fëmijët që të kujdesen për mjedisin i cili i rrethon.

Konkluzionet e këtij studimi, tregojnë se motivimi i fëmijëve është i rëndësishëm duke filluar qysh në moshën e hershme, për vetëdijesimin e tyre rreth rëndësisë që ka mjedisi në të cilin jetojnë. Në këtë kontekst, një faktor relevant qysh në hapat e tyre të parë, për edukimin mjedisor janë prindërit dhe familja, nga ku fëmijët marrin shembullin e parë dhe interesimin për rëndësinë e ambientit. Kështu pra, fëmijët edukohen ashtu siç shohin dhe udhëzohen nga prindërit, dhe prandaj themi se familja dhe prindërit janë një pasqyrë shumë e fortë për fëmijët e tyre në këtë aspekt. Një shtëpi e pastër dhe një ambient i pastër familjar, është pika fillestare nga e cila fëmijët nisen dhe e vazhdojnë rrugëtimin e tyre jetësor për një mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme. Nga ana tjetër, rrugëtimi i tyre drejt kësaj forme edukimi duhet të përforcohet akoma më shumë gjatë shkollimit të tyre në vijimësi, që të kemi kështu, një brez të edukuar dhe të kujdesshëm ndaj çështjeve mjedisore dhe ambientit në të cilin jetojnë.

Dhe fare në fund, si përfundime të përgjithshme, mbështetur në gjetjet tona në këtë studim, mund të pohojmë lirshëm se motivimi i fëmijëve sa i takon pastërtisë së mjedisit, është shumë i rëndësishëm për një të ardhme të shëndetshme të tyre dhe të mbarë shoqërisë.

LITERATURA

1. Balzano E, Miele C, Serpico M. Citizen Science and Environmental Education in Italy.
2. Braus J, Wood D, Environmental Education in the schools, (1993).
3. Broda H. W. Schoolyard – Enhanced Learning: “Using the Outdoors as an Instructional Tool”, (2007).
4. Bush, T., Middlewood, D. (2013), “Leading and Managing People in Education”; Saga Publications, Inc. London; Online ISBN: 9781446215753.
5. Christiansen J, Christianson D. Environment, Energy, resources, (2006).
6. Corno, L. (1994). Student vullnetin dhe arsimit: Rezultatet, ndikimet, dhe praktikat. Në Zimmerman BJ & NQ SCHUNK (ed.), Vetë-rregullor i të mësuarit dhe të performancës (f. 229-254). Hillsdale, NJ: Lawrence Erlbaum Associates.
7. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit & UNICEF. Edukimi Mjedisor për ciklin fillor. Libri i mësuesit, (2008).
8. Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, (2009).
9. Possible Developments and the Role of Universities, (2016).
10. Johnson B, Christensen L. Educational research: Quantitative, qualitative, and mixed approaches. Thousand Oaks, CA: Sage Publications, (2012).

11. Kanfer, R. Chen, G. Pritchard, R. (2008), Work Motivation: Forging New Perspectives and Directions in the Post-Millennium, Past, present and future”.
12. Korkmaz, i. “Motivimi ndaj nxënësit” Ankara 2002.
13. Locke, A. Edvin (2008), International Encyclopedia of Organization Studies, Thousand Oaks.
14. Marsden B. Why care for nature, (1997).
15. Mastori E. Vlerësimi i Edukimit Mjedisor në shkollë. Manual për Edukimin Mjedisor.
16. Scott P. Environmental education in the schools. Creating a program that works, (1993).
17. Stevenson R.B. Environmental Education, (1987).
18. Swathi.B (2013) “Intervetion research on working conditions and employee performance” International Monthly Refereed Journal of Research In Management & Technology, vol 2.
19. UNESCO, Deklarata Tbilisi, 1978.

Burime nga Interneti

<https://www.keshilla.net/mesuesi-dhe-motivimi-i-nxenesit/> (Lexuar më 01.06.2020).

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/reviste-e-permuajshme-nr-21-viti-iiidhjetor-2013.pdf> (Lexuar më 01.06.2020).

http://ammk-rks.net/repository/docs/broshura_new.pdf (Abdullah Pirçe, zyrtar i lartë për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor, “Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor”, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prishtinë, 2009, f. 4-5). (Lexuar më 06.06.2020).

http://documents.rec.org/offices/projects/4_outdoor_teacher_guide_web.pdf.

“Udhëzues për mësuesit në realizimin e edukimit mjedisor jashtë mureve të shkollës”. (Lexuar më 06.06.2020).

http://documents.rec.org/offices/projects/4_outdoor_teacher_guide_web.pdf.

“Udhëzues për mësuesit në realizimin e edukimit mjedisor jashtë mureve të shkollës”. (Lexuar më 06.06.2020).

<https://arditah.weebly.com/ndotja-dhe-mbrojtja-e-mjedisit.html>. (Lexuar më 05.07.2020).

<http://www.vet.al/files/projekte/MJEDISI.pdf>. (Lexuar më 05.07.2020).

SHTOJCA

PYËTESOR PËR NXËNËSIT E KLASAVE TË II-TA TË ARSIMIT 9-VJEÇAR

Të dashur nxënës,

Ju falënderojmë për kohën që do të na kushtoni, duke plotësuar këtë pyetësor. Ju informojmë se pyetësori ka qëllim vetëm studimor. Ju mund ta plotësoni atë, pa u identifikuar. Saktësia dhe objektiviteti i përgjigjeve tuaja janë shumë të rëndësishme për rezultatet e këtij studimi. Për të dhënë përgjigjen/mendimin tuaj, ju lutemi të rrethoni, ose vendosni shenjat (+) , (x) ose (√) në kutizat përkatëse. Përgjigjet e sakta mund të jenë më shumë se një. Mundësisht të keni dhe prindërit afër gjatë përgjigjes.

1. Format e ndotjes së shkaktuar nga njeriu?

Ndotja e ajrit Ndotja e ujit

Ndotja e tokës

2. Cilët janë ndotësit e atmosferës?

Industria

Transporti

Lendet djegëse

3. Kush janë ndotësit e ujit?

Mbeturinat

Ujrat e zeza

4. Cilat janë veprimet që ndikojnë në ndotjen e ujit?

Detergjentet

Produktet për pastrim

5. Cilët janë shkaktarët që ndikojnë në ndotjen e atmosferës - ajrit?

Qarkullimi urban Lëvizja me biçikleta Trafiku ajror

6. Si e vlerësoni mjedisin ku ju jetoni?

7. Si e vlerësoni mjedisin ku ju mësoni?

8. Kush është ndotësi më i madh i ambientit?

Njeriu Kafshët Bimët

9. A ndikon njeriu në ruajtjen e mjedisit?

10. Cilat veprimet duhet aplikuar për ruajtjen e tokës?

Klasifikimin i mbeturinave Hedhja e mbeturinave Riciklimi i mbeturinave

Faleminderit për pjesëmarrjen!



**UNIVERSITETI I MITROVICES
'ISA BOLETINI'**

Rr. Ukshin Kovaçica p.n. 40000 Mitrovicë
Republika e Kosovës

**FAKULTETI I EDUKIMIT
FORMULAR PAJTIMI**

I/E nderuar,

Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e një hulumtimi. Në këtë kuadër ne kemi zgjedhur të zhvillojmë këtë hulumtim.

Tema: “Mënyra e motivimit të fëmijëve për ruajtjen e mjedisit jetësor”

Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me ju, Ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

Një kopje e këtij konfirmimi mbetet tek ju.

[Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në vazhdimësi, ju lutem kontaktoni

Profesorin / Mentorin e punimit,në e-mail:

AUTOBIOGRAFI

Unë, Fjolla Ahmeti, jam e lindur në Mitrovicë më 12 shkurt të vitit 1996, ku dhe aktualisht jetoj.

Mësimet e para i mora në shkollën fillore "Eqrem Çabej" në Mitrovicë, për të vazhduar më tej në Gjimnazin "Frang Bardhi", po ashtu në Mitrovicë, Drejtimi - Shkenca Natyrore.

Prioriteti im kryesor, çdo herë ka qenë shkollimi, dhe kështu, vazhdova studimet Bachelor në Fakultetin e Mitrovicës "Isa Boletini ", Programi Fillor.

Në vitin 2017 u certifikova nga Berzh si lidere ndërmarrëse e bizneseve në Kosovë. Më 10 nëntor 2017, u specializova si grimere profesioniste, dhe po këtë vit, vazhdova me studimet për dizajn mode në Akademinë e Arteve "Evolucion" në Prishtinë. Dhe kështu, sa i takon fushës së bukurisë, në qershor të vitit 2018, kam startuar edhe me biznesin tim personal "Fjolla Ahmeti Make-Up", ku dhe aktualisht jam pronare, përmes së cilës veprimtari kam prezantuar dhe vazhdoj ta prezantoj të bukurën, jo vetëm në Kosovë, por edhe jashtë saj, me ç'rast isha e ftuar për Master Class në Shqipëri dhe Barcelonë. Në vitin 2018 nga 940 aplikantë nga e gjithë Kosova, u zgjodha të jem pjesë e Institutit më të lartë "Elitë" në Tiranë, për të vazhduar më tutje si bursiste, po në këtë Institut. Në dhjetor 2018, isha e ftuar speciale në Tiranë, me rastin e eventit më të madh në trojet shqiptare "AWARDS BUSINESS TREND ALBANIA", duke qenë pjesë e jurisë, ku dhe u certifikova nga Master Class Internacional. Ndërkaq, më 14 Prill 2020, mora ftesë nga "Runway Fashion Label" në New York, për të pranuar titullin 'Ambasadore', me etiketën 'Chic Nyc në NYFW 2020'.

Në shtypin vendor dhe rajonal deri më sot, janë shkruar shkrime dhe artikuj të shumtë mbi jetën dhe veprimtarinë time.